



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 3, datë 25.02.2026

PËR
MIRATIMIN E “RAPORTIT VJETOR TË
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2025”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 7, të nenit 52 pika 1, shkronja (l) të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 8, pika 2, shkronja “d” dhe të nenit 9, pika 3 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 6/1, shkronja “e” të Rregullores nr. 20, datë 25.09.2017 “Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të nenit 18 pika 2 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014, si dhe me propozim të Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raportit vjetor të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2025”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për paraqitjen e raportit vjetor për vitin 2025 pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Autoritetit Mbikëqyrës, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi dhe të raportit vjetor për vitin 2025 në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Donald Duraj

Shqipe Malaj

Kryetar

Sekretare



AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit, Nr. 317
Tiranë / Albania
t: +355 (4) 2362 989/2347 298 f: +355 (4) 2362 984
e: info@asd.gov.al n: www.asd.gov.al